



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI**

U R D H Ë R

Nr. 51, datë 28.05.2021

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS
PËR VLERËSIMIN DHE STANDARDIZIMIN E INFORMACIONEVE PËR
SHQIPËRINË DHE SHQIPTARËT NË PLATFORMAT
NDËRKOMBËTARE DIGJITALE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për vlerësimin dhe standardizimin e informacioneve në platformat ndërkombëtare digjitale, të cilat kanë në përmbajtjen e tyre informacion për Shqipërinë dhe shqiptarët.
2. Grupi ndërinstitucional i punës për vlerësimin dhe standardizimin e informacioneve në platformat ndërkombëtare digjitale, të cilat prodhojnë informacion për Shqipërinë dhe shqiptarët, të kryejë këto detyra:
 - a) Të identifikojë platformat ndërkombëtare digjitale, të cilat ofrojnë informacione për Shqipërinë dhe shqiptarët;
 - b) Të vlerësojë vërtetësinë dhe saktësinë e informacioneve, të cilat ndodhen në platformat ndërkombëtare digjitale që prodhojnë informacione për Shqipërinë dhe shqiptarët;



- c) Të realizojë dorëzimin përfundimtar të informacionit zyrtar pranë platformave, të cilat prodhojnë informacion për Shqipërinë dhe shqiptarët.
3. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga ministri përgjegjës për evropën dhe punët e jashtme dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
- a) Zëvendësministër i Brendshëm;
 - b) Zëvendësministër i Mbrojtjes;
 - c) Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - ç) Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - d) Zëvendësministër i Kulturës;
 - dh) Zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit;
 - e) Një përfaqësues nga ministri i Shtetit për Diasporën;
 - ë) Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave;
 - f) Drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
 - g) Dy përfaqësues nga Akademia e Studimeve Albanologjike.
4. Grupi ndërinstitucional i punës të mbledhet të paktën 3 (tri) herë në vit ose jashtë radhës me kërkesën e kryetarit të tij.
5. Institucionet e përmendura në pikën 3, të këtij urdhri, të caktojnë përfaqësuesit e tyre në këtë grup ndërinstitucional brenda 7 (shtatë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij.
6. Grupi ndërinstitucional i punës për vlerësimin dhe standardizimin e informacioneve në platformat ndërkombëtare digjitale, të cilat prodhojnë informacion për Shqipërinë dhe shqiptarët, të përgatitë raportim vjetor me shkrim për veprimtarinë e tij. Ky raportim i dërgohet Kryeministrit dhe të gjitha ministrive dhe publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).



7. Ngarkohen grupi ndërinstitucional i punës dhe institucionet e përmendura në pikën 3, të këtij urdhri, për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

E D I R A M A